

Tirane me 24.06.2015

Deklarate e Unionit te Gazetareve Shqiptare

Kriza ekonomike dhe financiare ne media si dhe informaliteti po shumefishojne poshterimin e gazetareve ne vend

Unioni i Gazetareve Shqiptare publikon letren qe nje grup i madh punonjesish dhe gazetaresh te Televizionit Agon Channel i drejtojne kryetarit te UGSH, ne te cilen kerkohet solidaritet per venine ne levizje te institucioneve dhe autoriteteve ligjore te vendit per padrejtesine qe lihet ne fuqi prej muajit maj te vitit 2015 ne kete media.

Ne letren e punonjesve te Agon Channel, theksohet se prej muajit maj te vitit 2015 punonjesit nuk jane paguar . Ata jane te shqetesuar dhe te fyer nga situata e krijuar. Edhe pse pronari i televizionit Francesco Beccetti gjendet ne probleme gjyqesore, punonjesit dhe gazetaret e kesaj medieje kane vijuar normalisht punen dhe ruajtjen e transmetimeve televizive. Ne letren e tyre drejtuar UGSH, punonjesit shtojne se edhe pse administrates se televizionit vijueshmerisht i kerkohen shpjegime per kete situat e cila po rendohet dita dites, ende nuk ka nje pergjigje zyrtare. Punonjesit i jane drejtuar edhe Ministrise se Financave per t'u informuar se ç'fare rruge duhet ndjekur, pas kalimit ne sekuestro preventive te televizionit, por reagimi ka ardhur permes Agjensise se Administrimit te Pasurive te Sekuestruara, sipas te cilit nuk mund te behet asnje veprim.

Perballe kesaj situat punonjesit kerkojne solidarizimin e Unionit te Gazetareve Shqiptare si publikimin e ketij problemi qe po zgjat prej tri muajsh per dhjetra gazeta, eksperte dhe punonjes te kesaj medieje.

Unioni i Gazetareve Shqiptare i drejtohet Prokurorit te Pergjithshem te Republikes zotit Adriatik Llalla qe duke respektuar legjislacionin e vendit, procesi i sekuestros dhe i hetimit te mos penalizojte indirekt gazetaret dhe punonjesit e televizionit Agon Channel, por ne baze te Kodit te Punes dhe legjislacionit perkates te mundesoje shperblimin financiar te punonjesve per punen dhe mundin e kryer ne perditshmeri. Unioni i Gazetareve Shqiptare kerkon nga ministri i Mireqenies Sociale dhe Rinise, zoti Blendi Klosi te vene ne levizje Inspektoratin e Punes dhe institucionet e tjera per zhbllokimin e financave per gazetaret dhe punonjesit e kesaj medieje.

Ne pritje te reagimit zyrtar dhe zgjidhjes pa vonese te kesaj situat, Unioni i Gazetareve Shqiptare paralajmeron pershkallezimin e reagimeve dhe qendrimeve tona sociale.

Diten e hene, date 27/07/2015 drejtuesit e UGSH do te dalin ne nje konference per shtyp per denoncimin e situates dhe paraqitjen e te dhenave te fundit rreth realitetit te krizes financiare dhe

informalitetit ne mediat e vendit. UGSH denoncon rishtazi se kriza e renduar financiare dhe informaliteti i shtuar ne media, po shumefishojne poshterimin e gazetaresve dhe punonjesve ne mediat shqiptare.

Zyra e Shtypit
Unioni i Gazetaresve Shqiptare